

Shoqata Pallçishti në Kuvendin e përgjithshëm të mbajtur më 11.03.2018 në Zürich të Zvicrës vendosi që të pranoj këtë Statut të ndryshuar dhe të plotësuar.

# Statuti i Shoqatës "Pallçishti"

## NENI 1

### Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Shoqata Pallçishti në Zvicër egziston që nga viti 2006 dhe është organizim i krijuar me vetë vullnetin e lirë të bashkëatdhetarëve nga Pallçishti që jetojnë në Konfederatën Zvicerane; është Shoqatë joqeveritare dhe jopartiake me karakter social, humanitar dhe kulturor, që mbështetet në parimet Demokratike Kushtetuese, mbi ligjet e Konfederatës Zvicerane dhe Normat Ndërkombëtare të së Drejtës.
- 1.2 Emri i Shoqatës është „Shoqata Pallçishti – Zvicër” (SHPZ – është shkurtesë e emrit të plotë të Shoqatës).
- 1.3 Shoqata ka statutin, rregulloren, logon dhe vulën e vet (nuk përjashtohet mundësia të ketë edhe flamurin e vet).
- 1.4 Adresa : Steinwiesenstrasse 1, 8952 Schlieren
- 1.5 Vula: Shoqata Dispononë vulë rrethore dhe katërore
- 1.6 E drejta juridike e Shoqatës është bazuar dhe përputhur me ligjet e Shtetit Zviceran, duke respektuar të drejtat dhe obligimet që dalin nga Neni 60ff i së drejtës civile Zvicerane (ZGB)
- 1.7 Shoqata nuk ushtron veprimtari fitimprurëse

## NENI 2

### Misioni dhe Qëllimi

Shoqata ka për qëllim:

- 2.1 Të japi ndihmë humanitare të llojllojshme për qytetaret e Pallçishtit të cilët janë në situatë të rend sociale, personave me aftësi të kufizuar, personat që preken nga sëmundje të ndryshme, gjatë fatkeqësive natyrore si dhe ndihma të tjera të këtij lloji.
- 2.2 Të ofroj ndihma për të gjitha Institucionet dhe shoqatat (Arsimore, Kulture, Fetare dhe të tjera) e fshatit Pallçisht.
- 2.3 Të ruaj, të zhvillojë dhe të kultivojë kulturën dhe traditën Shqipëtare për Shqipëtarët në Zvicër në veçanti Pallçishtasit.
- 2.4 Të japë ndihmesën për evidentimin e vlerave kulturore, artistike, sportive, etj.
- 2.5 Të ndihmojë integrimin e anëtarëve të Shoqatës në shoqërinë zvicerane, përmes aktiviteteve kulturore, sportive, humanitare, arsimore etj., në përputhje me statutin e Shoqatës.
- 2.6 Ndërtimin dhe përparimin e lidhjeve miqësore ndërmjet Pallçishtasve dhe qytetarëve zviceran pa marrë parasyshë përkatësinë e tyre nacionale apo fetare.
- 2.7 Të bashkëpunojë me organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe me institucionet shtetërore në Zvicër, në Maqedoni dhe në gjithë Botën me qëllim të promovimit të tolerancës ndëretnike, të bashkëpunimit dhe të realizimit të aktiviteteve humanitare, kulturore, sportive etj..
- 2.8 Përkujdesjen dhe afrimin e gjuhës shqipe dhe vlerave kombëtare.
- 2.9 Të njohë dhe të vlerësojë opinionin publik të Pallçishtit për problemet e ndryshme që u takojnë banorëve të Pallçishtit që jetojnë në Zvicër e që paraqesin interes të përbashkët t'i publikojnë ato. (Media, Shtyp, Internet etj.).
- 2.10 Të bashkëpunojë dhe të krijojë marrëdhënie partneriteti e lidhjeje reciproke me Shoqata që kanë qëllime dhe objektiva të ngjajshme.
- 2.11 Të ndikojë në rritjen e shkallës së solidaritetit në mes të anëtarëve dhe pallçishtasve në Zvicër.
- 2.12 Shoqata nuk është organizatë politike, por në rast se çenohen të drejtat legjitime të kombit shqiptar ka të drejtë të ngre zërin dhe të përkrahë kauzën e përgjithshme kombëtare me mjete të lejueshme legjitime dhe demokratike.

- 2.13 Shoqata ka të drejtë që të shpreh kritikën e sajë dhe të mbështes qytetarët me mjete të lejueshme legjitime në qoftëse çënohen zonat publike dhe interesat e Fshatit Pallçisht pa përfilljen e qytetarëve. Që do të thotë çdo investim në Fshatë të marë për bazë njoftimin e qytetarëve të Pallçishtit dhe të ketë pëlqimin e institucionit legjitim që përfaqëson qytetarët e Fshatit Pallçisht. (Bashkësis Lokale apo të ngjajshme)
- 2.14 Të përkrahë aktivitetet me karakter shkencor, edukativo-arsimor dhe informativ (psh. Tribunat letrare, kulturore, simpoziumet shkencore, Stimulimi i studentëve etj.).
- 2.15 Të themeloj një deg të saj në Pallçisht për bashkpunim dhe organizim të përbashkët.

## NENI 3

### **Struktura Organizative**

#### - Organet e Shoqatës:

- Kryesia

- Kuvendi

#### 3.1 Kryesia e Shoqatës

- 3.1.1 Kryesia e Shoqatës zgjidhet çdo 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje nga Kuvendi me votim të fshehtë apo në formë të hapur nëse kjo nuk kundërshtohet në kuvend.
- 3.1.2 Të drejtë kandidimi ka çdo person Fizik i moshës madhore që jeton në Zvicër me origjin nga Fshati Pallçisht në përputhje me Nenin 3 pika 3.1.3 të Statutit.
- 3.1.3 Personi që kandidohet apo propozohet duhet të jetë anëtar i shoqatës, me prejardhje nga Pallçishti dhe nuk duhet të jetë dënuar nga shteti Zvicërianë për krime të ndryshme, ose të jetë në proces të ndjekjes penale.
- 3.1.4 Kryesia përbëhet nga: kryetari, nënkryetari, sekretari, arkëtari dhe anëtarë të tjerë.
- 3.1.5 Numri i Anëtarëve të Kryesis nuk është i kufizua, por duhet të jetë gjithmonë numër tek.
- 3.1.6 Kryesia harton rregulloren e brendshme të funksionimit të Shoqatës dhe projekt-programin e saj periodik.

- 3.1.7 Kryesia ka të drejtë të marrë aktivitete konkrete dhe fonde përkatëse për realizimin e tyre duke ia drejtuar (dërguar) bashkëshatarve në mbledhjen e radhës.
- 3.1.8 Në funksion të Shoqatës, me aprovim të Kryesisë mund të bëhen aplikime për projekte të ndryshme.
- 3.1.9 Anëtarët e Kryesisë punojnë në mënyrë vullnetare dhe pa përfitime Personale.
- 3.1.10 Kryesia ka të drejtë të mer vendime dhe aprovime në mënyrë unanime në përputhje me rregulloren e shoqatës.
- 3.1.11 Kryesia e Shoqatës duhet të raportojë bilansin vjetor para Kuvendit të përgjithshëm.
- 3.1.12 Kryesia është përgjegjëse për shqyrtimin dhe mbikqyrjen e dokumenteve financiare dhe Projektve të Shoqatës

## 3.2 Kuvendi

- 3.2.1 Kuvendi është organi më i lartë i shoqatës dhe përbëhet nga të gjithë antarët e shoqatës
- 3.2.2 Kuvendi si organ më i lartë i Shoqatës, është i vetmi organ që ka fuqinë ligjore për të ndryshuar këtë statut të Shoqatës, duke u bazuar në ligjet dhe rregulloren për formimin e shoqatave jo profitabile dhe humanitare në Zvicër.
- 3.2.3 Kuvendi mer vendime dhe aprovime me shumicën e pjesëmarrësve. Kto vendime dhe konkluzione janë obligative për anëtarësinë e shoqatës. Votimi mund të bëhet në formë të hapur nëse kjo nuk kundërshtohet në kuvend.
- 3.2.4 Për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme në kuvend, kryesia ka të drejtë të ftojë ekspert të lamive të ndryshme por pa të drejtë vote.
- 3.2.5 Kuvendi nuk mund të merret me çështje që nuk janë të cekura në rend të ditës, me përjashtim nëse ka ndonjë propozim të argumentuar për kuvend të jashtëzakonshëm.
- 3.2.6 Në kuvendet e përgjithshme dhe takimet e kryesisë duhet të mbahet një Protokol (Procesverbal)
- 3.2.7 Për hyrjen në fuqi të një vendimi, përgjegjëse është Kuvendi i përgjithshëm.

## NENI 4

### Anëtarësia

- 4.1 Në Shoqatë ka të drejtë të anëtarësohet çdo person i moshës madhore që është me origjinë nga Pallçishti (që jeton brenda dhe jashtë Zvicrës) dhe çdo qytetarë tjetër që shfaq ndjenja miqësie dhe admirim ndaj popullit shqiptar (pa të drejtë kandidimi në organet e Shoqatës) dhe që pranon programin dhe statutin e Shoqatës pavarësisht nga gjinia, gjendja shoqërore, gjendja familjare, feja, banimi, puna, etj.
- 4.2 Çdo anëtarë i Shoqatës është i obliguar që të paguaj anëtarësinë vjetore në mënyrë të rregullt me një shumë simbolike prej 100 CHF, kurse pagesa mund të bëhet gjatë gjithë vitit kalendarik.
- 4.3 Asnjë anëtar nuk ka të drejtë të deklarojë publikisht asgjë në emër të Shoqatës, pa lejen paraprake të Kryesisë.
- 4.4 Çdo anëtarë ka të drejtë të ngrejë iniciativa dhe të parashtrojë propozime për diskutime për pyetje të caktuara dhe të marrin pjesë në diskutimin e tyre,
- 4.5 Çdo anëtarë ka të drejtë të propozoj ose të kundërshtoj (vetëm në bazë të argumenteve) një projekt me qëllim që shoqata ta mbështes ose përkrah projektin e propozuar.
- 4.6 Çdo anëtarë i pranishëm në mbledhje ka të drejtë vote, të zgjedhë dhe të zgjidhet.
- 4.7 E drejta për të dhënë dorëheqje i garantohet çdo anëtarë të Shoqatës pa asnjë kusht.
- 4.8 E drejta e anëtarësisë në Shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë trashigimie.
- 4.9 Anëtarët që kanë dhënë dorëheqje, ose janë përjashtuar nga Shoqata, nuk kanë të drejtë në kapitalin apo pasurinë themelore të Shoqatës.
- 4.10 Çdo anëtarë ka të drejtën e vet, të shfaqë mendimin e tij, të diskutojë në mbledhje, të kërkojë përgjegjësi dhe llogari prej Kryesisë dhe Kuvendit të Shoqatës.
- 4.11 Anëtarë ose anëtarja që nuk zbaton statutin dhe rregulloren, nuk i bindet Kuvendit, ka sjellje të dobët dhe shkakton një dëm për shoqatën, Kryesia mund t'i propozojë Kuvendit të përgjithshëm largimin e atij anëtarë, nëse këtë e sheh të arsyeshme.

- 4.12 Kryesia mund t'i propozojë Kuvendit të përgjithshëm largimin e një anëtari, nëse këtë e sheh të arsyeshme. Kryesia nuk është e obliguar t'i arsyetohet anëtarit të larguar.
- 4.13 Shoqata ka të drejtë të ketë anëtarë nderi dhe kohëzgjatja është e pacaktuar, në përjashtim të shkëljes së Statutit.
- 4.14 Anëtarët e nderit që nuk janë me origjin nga Pallçishti nuk kanë të drejtë të zgjidhen dhe të jenë të zgjedhur në Këshill, por kanë të drejtë të propozojnë në interes të Shoqatës.
- 4.15 Çdo anëtar duhet që të jepë kontribut të dukshëm për shoqatën në fushën që dëshiron.

## NENI 5

### **Të hyrat dhe të dalat e Shoqatës**

#### 5.1 Të hyrat e Shoqatës përbëhen nga:

- 5.1.1 Anëtarësia
- 5.1.2 Sponzorët
- 5.1.3 Fitimet nga aktivitetet e ndryshme
- 5.1.4 Manifestimet kulturore dhe turniret
- 5.1.5 Pagesat vullnetare dhe dhuratat

#### 5.2 Daljet e Shoqatës përbëhen nga:

- 5.2.1 Kostot administrative
- 5.2.2 Pagesa e zyrës (qiraja)
- 5.2.3 Marketingu (Reklama)
- 5.2.4 Të dalat e Shoqatës që përcaktohen nga Kuvendi i përgjithshëm dhe Kryesia.
- 5.2.5 Të dalat që përcaktohen nga Statuti që përmbushin qëllimet dhe detyrat e Shoqatës.

## NENI 6

### **Sponzorët**

- 6.1 Sponzorë në Shoqatë mund të jenë të gjithë ata persona fizik dhe persona juridik që e pranojnë rregulloren e Statutit të Shoqatës për Sponzorizim.
- 6.2 Shoqata posedon rregullore të posaçme për Sponzorim (rregullat e sponzorimit caktohen nga Kryesia)

## Dispozita përfundimtare

- 7.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës është e pakufizuar.
- 7.2 Shkapërderdhja, bashkimi dhe përshtatja e synimit të Shoqatës mund të bëhet vetëm në Kuvendin e përgjithshëm, me shumicën absolute të pranishmive me të drejtë vote.
- 7.3 Ndryshimet dhe plotësimet në Statut miratohen me Kuvend të përgjithshëm me shumicën absolute të pranishmëve me të drejtë vote.
- 7.4 Në rast të shpërbërjes së Shoqatës, të mirat e Shoqatës dhe inventari (do të shitet sipas nevojës) do të shlyhen të gjitha pagesat, e pjesa e mbetur do t'i jepet ndonjë Organizate në Pallçisht që ka qëllime të njejta, ndonjë Fondi humanitar në Pallçisht, bursa studentore në Pallçisht etj., për ç'gjë vendos Kryesia e Shoqatës.
- 7.5 Çdo ndryshi i Statutit dhe Rregullores së shoqatë duhet të bëhet në përthuje me Nenin 3 pikat 3.2.2 dhe 3.2.3 të Statutit të Shoqatës.
- 7.6 Ky Status hyn në fuqi 30 ditën pas marjes së vendimit të Kuvendit, për të dhën mundësi dhe hapësir Anëtarëve të Shoqatës për vërejtje.
- 7.7 Shoqata Pallçishti – Zvicër në Kuvendin e përgjithshëm, të mbajtur më 11.03.2018 në Steinwiesenstrasse 1, 8952 Schlieren (Klubi Pallçishti) të Zvicrës, vendosi që të pranojë këtë Statut të ndryshuar dhe të plotsuar nga Statuti i kaluar.

Nënshkruesit e Statutit të Shoqatës Pallçishti – Zvicër:

---

Krytar:  
Enis Sulimani

---

Nënkryetar:  
Senat Idrizi

---

Sekretar:  
Gadaf Muharemi

---

Arkëtarë:  
Mentor Ziberi

---

Anëtarë i Kryesisë  
Ziber Ziberi

---

Anëtarë i Kryesisë  
Riza Izairi

---

Anëtarë i Kryesisë  
Ali Ademi